



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr.56, datë 06.07.2016

Për

**“VENDOSJEN E EMRIT “BEDRI LLAGAMI” SHKOLLËS SË MESME VAQARR”**

Bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9/1.7 ”b”; neni 54 shkronja “ll” të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, me propozim të një grupi këshilltarësh, pasi mori në shqyrtim kërkesën për propozim për emërtimin e shkollës së mesme në Vaqarr, me emrin e Mësuesit të Merituar, Bedri Myslym Llagami, arsimtar dhe drejtues që la gjurmë me punën e tij, në arsimimin dhe edukimin e brezave të tërë, Këshilli Bashkiak i Tiranës,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë propozimin për emërtimin “Bedri Llagami” të shkollës së mesme në Vaqarr.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**